

V E N D I M
Nr. 233, datë 22.5.1999

**PËR DISA MASA PËR ZBATIMIN E EMBARGOS SË NAFTËS DHE TË
NËNPRODUKTEVE TË SAJ NDAJ REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të rezolutave nr.1160, 1199 dhe 1203, të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për krizën në Kosovë, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Rendit Publik, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave të marrin të gjitha masat për të ndaluar daljen nga pikat e kalimit kufitar, shqiptar, të naftës e të nënprodukteve të saj, për në Republikën Federale të Jugosllavisë.

2. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të organizojnë punën për ndalimin e kalimit, të qëndrimit ose të nisjes nga territori i Republikës së Shqipërisë të mjeteve të lundrimit, të fluturimit apo të transportit tokësor, të ngarkuara me naftë e nënprodukte të saj, të cilat kanë si vendmbërritje përfundimtare Republikën Federale të Jugosllavisë.

3. Subjektet private, që importojnë naftë ose nënproduktet e saj, janë të detyruara të paraqesin në organet doganore, një javë përpara, kontratat për lëvrimin e mallit, për çdo sasi që do të importohet nga ata.

4. Subjektet private, që tregtojnë naftë ose nënprodukte të saj, me shumicë, të prodhuara në vend ose të importuara, janë të detyruara të paraqesin pranë autoriteteve përkatëse kontratat e lidhura me subjektet, që tregtojnë shitjen me pakicë të këtyre produkteve.

5. Subjektet transportuese janë të detyruara të hartojnë dokumentacionin shoqërues të mallit që transportojnë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me kontratat, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi.

6. Ndalohet depozitimi i çdo sasie karburanti pranë dhe gjatë gjithë brezit kufitar me Republikën Federale të Jugosllavisë. Shtrirja e brezit të jetë 5 km në vijë ajrore, nga vija e kufirit shtetëror, në brendësi të territorit shqiptar.

Pikat dhe depozitat e karburantit, të cilat ndodhen brenda këtij brezi të bllokohen dhe të mos lejohet hapja e pikave apo e depozitave të tjera, deri në përfundimin e embargos.

7. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, që kanë pësuar ose që pësojnë dëme nga zbatimi i embargos, të bëjnë përlllogaritjet dhe t'ia paraqesin ato Këshillit të Ministrave.

8. Ngarkohen ministrinë përkatëse për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko